

# RAPORT

**mbi verifikimin e 6,445 zarfeve me fletëvotime nga jashtë të ardhura përmes postës pas afatit ligjor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës - 2019**

Prishtinë, dhjetor 2020

Me 12 maj 2020, Organizata GERMIN ka kërkuar nga Posta e Kosovës verifikimin e datave të pranimit të 6,445 zarfeve me fletëvotime nga jashtë për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të vitit 2019, të cilat kanë arritur pas datës 5 tetor 2019 si afati i fundit i vendosur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për pranimin e votave nga jashtë).

Kjo kërkesë ka ardhur pasi që KQZ fillimisht ka refuzuar të pranojë pakot me fletëvotime të ardhura pas datës 5 tetor 2019. Posta e Kosovës, përkatësisht Drejtoria e Inspektorëve Postar i është përgjigjur pozitivisht kërkesës së GERMIN, duke mundësuar verifikimin e datave të pranimit të zarfeve në fjalë në Qendrën Tranzite Postare (QTP).

Ky raport paraqet të gjeturat kryesore nga ky proces i verifikimit i kryer nga ekipi i GERMIN.

# RAPORT - VOTIMI JASHTË VENDIT - 2019

## Përmbajtja

Datat e nisjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime për  
Zaiedhiet për Kuvendin e Kosovës - 2019

3

Datat e arritjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime për  
Zaiedhiet për Kuvendin e Kosovës - 2019


4

Shkelja e Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/4 Për  
Rreçullimin e Shërbimeve Univerzale Postare

5

# RAPORT - VOTIMI JASHTË VENDIT - 2019

## Datat e nisjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës - 2019



**Figura 1. Datat e nisjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime nga jashtë**

Organizata GERMIN, gjatë vëzhgimit të verifikimit dhe numërimit të votave me postë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ka vërejtur se janë refuzuar 6,445 (fillimisht 4,639, pastaj 1,806) zarfe me fletëvotime, të cilat sipas KQZ-së kanë arritur pas afatit ligjor (5 tetor 2019) për arritjen e zarfeve me fletvotime nga jashtë vendit në KQZ.


6,445 zarfet me fletëvotime janë pranuar, verifikuar dhe numëruar nga KQZ vetëm pas aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës: A.A.-U.ZH.nr. 20/2019, datë 30.08.2019, dhe A.A.-U.ZH.nr. 21/2019, datë 05.11.2019.

Gjatë këtij procesi, vëzhguesit e GERMIN kanë identifikuar datat e dërgimit (nisjes) të të gjitha pakove të ardhura në Kosovë pas datës 5 tetor 2019, dhe kanë vërejtur se të gjitha paket janë dërguar (nisur) para afatit ligjor, mirëpo për shkaqe teknike të postës nuk kanë arritur në kohë.

Figura 1 paraqet të dhënat mbi datat e dërgimit të 6,445 pakove me fletëvotime, të cilat kanë arritur pas afatit të vendosur nga KQZ. Siç shihet në figurën 1, të gjitha zarfet janë nisur si dërgesa postare para afatit ligjor, përjashtimisht 371 pakove, data e dërgimit e të cilave ka qenë e paidentifikueshme.

# RAPORT - VOTIMI JASHTË VENDIT - 2019

## Datat e arritjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës - 2019



**Figura 2. Datat e arritjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime nga jashtë në Qendrën Tranzite Postare**

Drejtorja e Inspektoratit Postar në kuadër të Postës së Kosovës, me datë 20.05.2020 ka përgatitur një raport të detajuar mbi datat e arritjes së 6,445 zarfeve me fletëvotime, pas kërkesës së GERMIN për një gjë të tillë.

Siç shihet në figurën 2, sipas raportit të Drejtorisë së Inspektoratit Postar, të gjitha zarfet e refuzuara fillimisht nga KQZ, kanë arritur pas datës 5 tetor 2019. Mirëpo, ajo çka vërehet në figurën 2 është rrjedha jo e natyrshme të arritjes së zarfeve me fletëvotime. Vetëm në datën 08.10.2019 kanë ardhur gjithsej 4,819 zarfe, apo 75% nga totali prej 6,445 dërgesave të ardhura pas datës 05.10.2019.

**Vetëm në datën 08.10.2019 kanë ardhur gjithsej 4,819 zarfe, apo 75% nga totali prej 6,445 dërgesave të ardhura pas datës 05.10.2019.**

Posta e Kosovës nuk jep ndonjë përgjigje të detajuar për këtë rrjedhë jo të natyrshme, por përmendet falimentimi i kompanisë së fluturimeve "Adria Airways" si shkaktar për vonesat në ardhjen e zarfeve me fletëvotime. Gjithsesi, nuk është akoma e qartë lidhja shkakore e falimentimit të kësaj kompanie me vonesat në arritjen e zarfeve.

# RAPORT - VOTIMI JASHTË VENDIT - 2019

## Shkelja e Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/4 Për Rregullimin e Shërbimeve Univerzale Postare

Inspektorati Postar, pas verifikimeve ka evidentuar shkeljen e Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/4 Për Rregullimin e Shërbimeve Univerzale Postare, përkatësisht Nenit 14 (vula datare postare) nga ana e kontrollorëve të Zyrës së Shpërndarjes së Postës. Këta të fundit nuk i kanë vulosur me vula datare në ardhje asnjë prej 6,455 zarfeve me fletëvotime të pranuar nga Qendra Tranzite Postare, edhe pse obligohen ta bëjnë një gjë të tillë sipas Udhëzimit Administrativ në fjalë.

Arsyetimi i kontrollorëve të zyrës postare për mos vulosje me vula datare në ardhje të 6,455 zarfeve është se ka pasë mungesë të materialit apo pajisjes për vula datare, si pasojë e krizës financiare të Postës së Kosovës dhe pamundësisë për t'i siguruar ato. Kjo shkelje raportohet të jetë përsëritur në vazhdimësi në mungesë të materialeve dhe pajisjeve të nevojshme. Mirëpo, e njejta bëhet edhe më shqetësuese sidomos në rastin e zarfeve me fletëvotime duke ditur rëndësinë dhe ndjeshmërinë e këtyre të fundit.

Në këtë drejtim, një problem tjetër që haset në dokumentet dhe evidencat e Drejtorisë së Inspektoratit Postar është

**Kontrollorët e Zyrës së Shpërndarjes së Postës kanë bërë shkelje të Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/4 Për Rregullimin e Shërbimeve Univerzale Postare, duke mos vulosur me vula datare në ardhje asnjë prej 6,455 zarfeve me fletëvotime të ardhura pas datës 05.10.2019**

tërheqja me vonesë e zarfeve me fletëvotimeve të ardhura pas datës 05.10.2019 nga ana e KQZ-së, edhe pse këta të fundit janë lajmëruar me kohë nga punëtorët e Postës. Poashtu, të njejtat zarfe edhe kur janë tërhequr në QTP nga KQZ-ja, nuk janë përcjellë nga Policia e Kosovës.

**Drejtorja e Inspektoratit Postar konstaton se të gjitha zarfet me fletëvotime të ardhura deri pas 05.10.2019 janë tërhequr në QTP nga zyrtarët e KQZ pa përcjellje të Policisë siç ka ndodhur me zarfet e ardhura para 5 tetorit.**